



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova
Dental Chamber of Kosovo



N.T.P ALLIANZ
Vellusha e Poshtme nr. 22 PRISHTINË

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MIDIS
ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS DHE
N.T.P ALLIANZ**

**Neni 1
Qëllimi**

Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe N.T.P ALLIANZ (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunimin e qëndrueshëm në fushën e shkëmbimit të informacioneve, përvojave dhe organizimit të përbashkët të trajnimeve, kurseve, seminareve, punëtorive, simpoziumeve, konferencave dhe kongreseve (në vazhdim *Ngjarjet*).

Neni 2

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për të nxitur dhe mbështetur këto *Ngjarje* në përputhje me nevojat dhe kërkesat profesionale të stomatologëve, infermierëve dhe teknikëve dentar si edhe për të lehtësuar e mundësuar pjesëmarrjen sa më të gjërë të tyre në këto *ngjarje*.

**Neni 3
Vendosja e shtandeve**

Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK) zotohet ta ftojë NTP Allianz për çdo ngjarje që e organizon, që të jetë prezent dhe të vendosë stenden për promovimin, reklamimin dhe shitje e produkteve të saja. Për këtë, NTP Allianz obligohet që OSK-së t'i ofrojë mbështetje rreth organizimit të *Ngjarjeve*.

Neni 4
Reklamimi i ndërsjellët

Palët obligohen ta vendosin linkun e web-faqes së njëj tjetës në web-faqet e tyre.

Neni 5
Ndarja e shpenzimeve sipas marrëveshjes së palëve

Palët zotohen që me marrëveshje të ndërsjellët t'i ndajnë detyrat dhe obligimet e përgjithshme në rastet kur organizimi i *Ngjarjeve* është i përbashkët, Ndarja e shpenzimeve për organizimin e *Ngjarjeve* (ku përfshihen sallat, ligjeruesit e ftuar, drekat dhe darkat për ligjerues të ftuar dhe mysafir të ftuar, tj.) bëhet sipas marrëveshjes paraprake.

Neni 6

Palët reciprokisht do të informojnë njëra tjetrën për ecurinë e zhvillimit të *Ngjarjeve* për të arriturat, problemet dhe mangësitë.

Neni 7
Miratimi, ndryshimet dhe hyrja në fuqi

Ky memorandum është i vlefshëm derisa *Palët* të mos kenë kërkuar shfuqizimin e tij. *Palët* mund të ndryshojnë ose të plotësojnë dispozitat e këtij Memorandumi, kur paraprisht dakordohen.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

Neni 9

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 12 Qershor 2019

Për Odën e Stomatologëve të Kosovës

Prof.Dr. Blerim Kamberi,
Kryetar i OSK



Për NTP Allianz

Muharrem Rashiti,
Drejtor Ekzekutiv

